



QENDRA MULTIFUNKSIONALE
POGRADEC Sh.a

**QENDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC Sh.a
ADMINISTRATORI**

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____. ____ .2024

Lënda: Në përgjigje të shkresës Suaj, Nr. 02/24 prot, datë 08.01.2024.

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Rruga "Abdi Toptani", Nd. 5, Tiranë.

**PËR DIJENI: BASHKISË POGRADEC
Znj. Arsila ÇINA**

POGRADEC

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 6, pika 1, shkronja "a", të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", neni 17, pika 1 shkronja "a", të Ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 109, datë 02.12.2021 "Për themelimin e shoqërisë "Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a" dhe miratimin e aktit të themelimit", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.110, datë 02.12.2021, "Për miratimin e statutit të shoqërisë "Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a", të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 1196/1 prot, datë 14.12.2021.

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 02/24 Prot, datë 08.01.2024, me lëndë, "Kërkesë", e protokolluar pranë Bashkisë Pogradec Nr. 2559/2 Prot, datë 21.07.2023, po Ju informojmë si më poshtë vijon:

Me Vendim të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë Nr. 4, datë 13.01.2022, është miratuar struktura, fondi i pagave dhe shpërblimeve për Shoqërinë Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.A, të detajuar si më poshtë vijon:

	Pozicionet në Strukturë	Numri i pozicioneve sipas strukturës	Paga mujore bruto/Lekë	Rregullimi i marrëdhënies së punës
1	DREJTORI I PERGJITHSHEM	1		Neni 158 i Ligjit Nr. 9901
	QENDRA KULTURORE LASGUSH PORADECI	19		
2	Drejtori i Qendres Kulturore	1		Kodi i Punës
3	Specialist per aktivitetet artistike	2		Kodi i Punës
4	Specialist regjisor /aktor	1		Kodi i Punës
5	Specialist -aktor	3		Kodi i Punës
6	Specialist-Koreograf	1		Kodi i Punës
7	Specialist per artin pamor dhe galerine e arteve	1		Kodi i Punës
8	Specialist-Skenograf	1		Kodi i Punës
9	Specialit instrumentis me 6 orë	1		Kodi i Punës
10	Kengetare me 6 orë	1		Kodi i Punës
11	Fonist	1		Kodi i Punës
12	Punonjes teknik audiovizive	1		Kodi i Punës
13	Punonjes skene	1		Kodi i Punës
	Biblioteka publike "Mitrush Kuteli"			
14	Përgjegjës Bibliotekes	1		Kodi i Punës
15	Specialist i bibliotekës	3		Kodi i Punës
	SEKTORI ADMINISTRATES DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE	12		
16	Pergjegjes sektori	1		Kodi i Punës
17	Pergjegjes i deges ekonomike	1		Kodi i Punës
18	Specialist finance	1		Kodi i Punës
19	Jurist	1		Kodi i Punës
20	Magaznier	1		Kodi i Punës
21	Punonjese sherbimi (Sanitare), I	1		Kodi i Punës
22	Punonjese sherbimi (Sanitare), II	2		Kodi i Punës
23	Punonjes sherbimi	4		Kodi i Punës
	DREJTORIA E SPORTEVE	7		
24	Drejtor	1		Kodi i Punës
	Sektori per aktivitetet sportive			
25	Përgjegjës Sektori	1		Kodi i Punës
26	Specialist per aktivitetet sportive	2		Kodi i Punës

	Sektori per menaxhimin e ambienteve sportive dhe kulturore	3	
27	Pergjegjes sektori	1	Kodi i Punës
28	Punonjës për koordinimin dhe mbarëvajtjen aktiviteteve në ambjentet sportive	1	Kodi i Punës
29	Punonjës shërbimi për ambjentet sportive	1	Kodi i Punës
	Totali	39	

Tek kolona "Paga mujore bruto/Lekë", jemi të detyruar ta pasqyrojmë bosh, pasi është e dhënë personale dhe dhënia e informacionit dëmton të drejtën e punonjësve për një jetë private.

Në përgjigje të kërkesës së dytë, ku kërkoni "Kopje të listës së punonjësve të Qendrës sipas pozicioneve të punës së tyre", po Ju informojmë se:

Në respektim të; nenit 6, pika 1, shkronja "a", të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008. "Për mbrojtjen e të dhënave personale", nenit 17, pika 1 shkronja "a", të Ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", NUK mund T'iu pajisim me kopje të listës së punonjësve, për arsyet ligjore si më poshtë:

1. Dhënia e informacionit dëmton interes e punonjësit dhe cënon të drejtën për një jetë private.
2. Subjektet e të dhënave personale NUK kanë dhënë pëlqimin e tyre.

Nga ana Jonë, mbetemi në dispozicion, për informimin dhe dërgimin e dokumentacionit, sa herë Ju e shihni të nevojshëm,

Ju Faleminderit!

ADMINISTRATOR
Dorian LATIFLLARI

